



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1454/4 prot.

Datë 25.08.2023

V E N D I M
Nr. 812/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.08.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*”, me Nr. REF-72711-06-15-2023, me objekt: “*Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore*”, me fond limit 750.000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, “ECO – ELB” SHA.

Vendim Deklarativ bazuar në nenin: Neni 118, Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku Komisioni Prokurimit Publik merr vendimin deklarativ mbi bazën e të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankimuesin që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së ligjit 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’

Ankimues:

Operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit”
SHPK
Zona Kadastrale 2679, Hyrja 2, AP.39, Kashar, Mëzez
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

“ECO – ELB” SHA

Lagjja “Brigada 17 Sulmuese”, Bulevardi “Qemal Stafa”,
Elbasan

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 6/15/2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit *Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*, me Nr. REF-72711-06-15-2023, me objekt: “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i

raporteve mjedisore”, me fond limit 750.000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, “ECO – ELB” SHA.

II.2. Në datën 19.06.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe klasifikimin përfundimtar, si më poshtë vijon:

1. “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK 698.000 lekë, skualifikuar;
2. “ Eko-Studio-Projekt” SHPK 742.000 lekë, kualifikuar

II.3. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar në datën 19.06.2023 operatorin ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, me arsyen si më poshtë vijon:

OPERATORI “ QENDRA E MONITORIMIT TE MJEDISIT ”

Operatori ekonomik “ Qendra e Monitorimit te Mjedisit “ nuk përmbush kriterin 2.3.2 te DST . 2.3.2 Operatori duhet të ketë një laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për matjen e parametrave të mikroklimes, zhurmës, cilësisë së ajrit në mjedis, cilësisë së ajrit në shkarkime stacionare, cilësisë së ujit dhe të radioaktivitetit.

OE nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025 për matjen e parametrave te cilesise se ajrit ne mjedis dhe radioaktivitetit.

Operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit te Mjedisit “ nuk përmbush kriterin 2.3.7 te DST .

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë përpara datës së shpalljes së kësaj gare, si pjesë të stafit të tij, të paktën 2 (dy) Inxhinierë Mjedis, të diplomuar me bachelor dhe/ose master, një Inxhinier Gjeomjedis, me diplomë master si dhe të paktën një specialist/e të diplomuar me master në Kimi Industriale/Mjedisore, dhe/ose diploma të ngjashme me to, etj.

OE nuk ploteson kushtin pasi ne dokumentet e dorezuara ne rruge elektronike nuk ka ne staf nje Inxhinier Gjeomjedis me diplome Master.

Operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit te Mjedisit“ nuk përmbush kriterin 2.3.11 te DST . 2.3.11 Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

OE nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa me sipër, operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit “ sh.p.k. nuk kualifikohet.

II.4. Në datën 20.06.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar fituesin në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E.)

II.5. Në datën 26.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është dorëzuar ankesa me nr. protokollit 1454, datë 26.06.2023, e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 26.06.2023 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në mënyrë shkresore njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr.1454/2 prot., datë 27.06.2023, është publikuar arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 357/1 prot, datë 05.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 1454/3 prot., datë 06.07.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK., ku rezulton, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën.

II.9. Nga verifikimet e kryera rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1 Autoriteti Kontraktor ka skualifikuar operatorin ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK me arsyen se:

“OPERATORI “ QENDRA E MONITORIMIT TE MJEDISIT ”

Operatori ekonomik “ Qendra e Monitorimit te Mjedisit “ nuk permbush kriterin 2.3.2 te DST .
2.3.2 Operatori duhet të ketë një laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për matjen e parametrave të mikroklimës, zhurmës, cilësisë së ajrit në mjedis, cilësisë së ajrit në shkarkime stacionare, cilësisë së ujit dhe të radioaktivitetit.

OE nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025 për matjen e parametrave të cilësisë së ajrit në mjedis dhe radioaktivitetit.

Operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit te Mjedisit “ nuk permbush kriterin 2.3.7 te DST .

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë përpara datës së shpalljes së kësaj gare, si pjesë të stafit të tij, të paktën 2 (dy) Inxhinierë Mjedisit, të diplomuar me bachelor dhe/ose master, një Inxhinier Gjeomjedisit, me diplomë master si dhe të paktën një specialist/e të diplomuar me master në Kimi Industriale/Mjedisore, dhe/ose diploma të ngjashme me to, etj.

OE nuk plotëson kushtin pasi në dokumentet e dorëzuara në rrugë elektronike nuk ka në staf një Inxhinier Gjeomjedisit me diplomë Master.

Operatori ekonomik “ Qendra e Monitorimit te Mjedisit“ nuk permbush kriterin 2.3.11 te DST .

2.3.11 Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

OE nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa me sipër, operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit te Mjedisit “ sh.p.k. nuk kualifikohet. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës me nr. 1454 prot, datë 26.06.2023, paraqitur nga operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK ka lidhje me vendimet e autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 118, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin

ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik. 3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji; b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj; c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji”, Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.2. Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se keto kriterë janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi shkakton kufizim e cenon konkurrencën, duke kufizuar pjesëmarrjen e ofertuesve në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe nuk i shërben autoritetit kontraktor, konkretisht KPP vëren se:

III.1.3. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Në shtojcën nr. 9, “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

“2.3.2 Operatori duhet të ketë një laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për matjen e parametrave të mikroklimës, zhurmës, cilësisë së ajrit në mjedis, cilësisë së ajrit në shkarkime stacionare, cilësisë së ujit dhe të radioaktivitetit.

2.3.11 Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë përpara datës së shpalljes së kësaj gare, si pjesë të stafit të tij, të paktën 2 (dy) Inxhinierë Mjedis, të diplomuar me bachelor dhe/ose master, një Inxhinier Gjeomjedis, me diplomë master si dhe të paktën një specialist/e të diplomuar me master në Kimi Industriale/Mjedisore, dhe/ose diploma të ngjashme me to, etj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara.

III.1.4 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor rezulton se, operatori ekonomik "Qendra e Monitorimit të Mjedisit SHPK" në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur:

-Certifikatë Akreditimi me nr. regjistri LT096 me datë vlefshmërie deri më 15.08.2023.

III.1.5 Ne DST autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

1. Objektivat e këtij vlerësimi janë:

- të pasqyrojë emisionet e lëngeta, cilësinë e tyre dhe ndikimin e tyre në ujërat pritëse;
- të pasqyrojë nivelin e grimcave të ngurta pezull në ajër;
- të pasqyrojë nivelin e zhurmës së aktivitetit dhe ndikimit në popullatën lokale;
- të pasqyrojë nivelin e gazeve të emetuar në ajër;
- të kryejë një vëzhgim të përgjithshëm mbi ndotjen dhe ndikimet evidente në mjedisin përreth zonës së aktivitetit;
- të nxjerrë rezultate në lidhje me performancën e përgjithshme mjedisore të aktivitetit;
- të japë rekomandime për përmirësime të mundshme teknologjike dhe menaxhimi që mund të sjellin ulje të ndikimit në mjedis.

2. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të gjitha të dhënat mbi programin e monitorimit në landfill-in e Elbasanit:

Nr.	Lloji i shkarkimit apo mjedisit që monitorohet	Parametri mjedisor që monitorohet	Vendi/pozicioni/Pika e monitorimit (matjes apo mostrimit/kampionimit)
------------	---	--	--

1	Uje (moster e ujrave siperfaqesore)	1.pH 2.Temperature 3.DO 4.BOD5 5. COD 6.N-NH4 7. Rrjedhia ditore 8.Rrjedhia maksimale 9.P-total	3 mostra 1.Ne rrjedhen e sipërme të lumit Shkumbin (20 cm thellësi) X: 4420832.50 Y: 4550506.08 2.Ne rrjedhen e poshtme të lumit Shkumbin (20 cm thellësi) X: 4420273.51 Y: 4550235.25 3.Uje i shesheve të impiantit X: 4421104.63 Y: 4550727.88
2	Uje (Shkarkimet në kanalizime)	1.pH 2.Temperature 3.DO 4.BOD5 5. COD 6.N-NH4 7. Rrjedhia ditore 8.Rrjedhia maksimale 9.P-total 10.Lende pezull 11..N-Total	1 moster X: 4421104.630 Y: 4550727.888
3	Uje (moster ujore nëntokësore të puseve piezometrik)	1.pH 2.Turbiditeti 3.Lendet pezull 4.Konduktiviteti elektrik 5.Oksigjen i tretur 6.BOD5 7.COD 8.N-NO3 9.N-total 10.P-total 12.Cl- 13.Arseniku 14.Bakri 15.Plumbi 16.Nikeli 17.Kromi VI 18. Zinku 19.Hekur 20.Koliform total	4 mostra Piezometri 1 X: 4420464.94 Y: 4550553.74 Piezometri 2 X: 4420528.51 Y: 4550431.47 Piezometri 3 X: 4420366.83 Y: 4550375.61 Piezometri 4 X: 4420328.38 Y: 4550502.35
4	Ajer	1.Grimca të ngurta në ajër (LNP mes& LNPmax &PM10)	4 pika Pika 1 Impianti i trajtimit të leksivateve

		<p>2. Gaze</p> <ul style="list-style-type: none"> • CO • NO2 • SO2 • CXHY 	<p>X: 4421104.63 Y: 4550727.88</p> <p>Pika 2 Ne juglindje te landfill-it X: 4420511.88 Y: 4550434.88</p> <p>Pika 3 Ne verilindje te landfill-it X: 4420464.47 Y: 4550549.40</p> <p>Pika 4 Ne hyrje te lanfill-it X: 4420370.91 Y: 4550376.29</p>
5	Çlirimi I zhurmes ne mjedis (ndotja akustike)	<p>1.Niveli i zhurmes per parametrat</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ LAeq ▪ LAmx 	<p>4 pika</p> <p>Pika 1 Ne verilindje te landfill-it X: 4420464.47 Y: 4550549.40</p> <p>Pika 2 Ne juglindje te landfill-it X: 4420511.88 Y: 4550434.88</p> <p>Pika 3 Ne jugperendim te lanfill-it X: 4420370.91 Y: 4550376.29</p> <p>Pika 4 Impianti i trajtimit te leksivateve X: 4421104.63 Y: 4550727.88</p>

Bazuar ne Urdhrin me Nr. 77 date 02.07.2020 Per proceduren e dorezimit/pranimit te dokumentave dhe raporteve te vetemonitorimit, **dokumentet per Zbatimin e Kushteve 3 Mujore**

Kushti i lejes Mjedisore	Zbatimi i kushteve periodike 3 mujore
1.6	Vendndodhja e ushtrimit te veprimtarise
6	Njoftimet
7	Shkarkimet
7	Plani i menaxhimit te tretesave organike
7	Inspektive Vizuale Ditore/Javore/Mujore per instalimet dhe shkarkimet ne ajer, uje, toke, zhurme, mbetje.
7	Mirembajtja/Plani i Sherbimeve
8	Menaxhimi i mbetjeve
8	Plani i Menaxhimit te mbetjeve

9	Zhurmat dhe Vibracionet
11	Monitorimi
12	Dokumentimi dhe Raportimi
12	Raporti Periodik i Monitorimit

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve periodike bazuar në Urdhrin nr. 77, datë 02.07.2020 “Për procedurat e dorëzimit/pranimi të dokumenteve dhe raporteve të vetëmonitorimit”

Afatet e ekzekutimit:

Lloji i shkarkimit apo mjedisit që monitorohet	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
<i>Ujë (moster e ujërave sipërfaqësore)</i>	<i>Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit</i>	<i>- Deri në 22 Qershor</i>
<i>Ujë (shkarkimet në kanalizime)</i>	<i>Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit</i>	<i>- Deri në 22 Qershor</i>
<i>Ujë (moster ujore nëntokësore të puseve piezometrik)</i>	<i>Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit</i>	<i>- Deri në 22 Qershor</i>
<i>Ajër</i>	<i>Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit</i>	<i>- Deri në 22 Qershor</i>
<i>Çlirimi i zhurmës në mjedis (ndotja akustike)</i>	<i>Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit</i>	<i>- Deri në 22 Qershor</i>

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.7 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.8. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit. 4.1 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat

profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e procedurës së prokurimit "Shërbim konsulence", stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. 5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë. b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi. c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës. ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. 7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e

dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues *“Qendra e Monitorimit të Mjedisit”* SHPK ka të bëjë përkatësisht me pretendime për përmbushjen nga e tij të kriterëve të sipercituara .

Referuar ankesës së operatorit ekonomik, KPP thekson, se në lidhje me të njëjtin objekt është shprehur me parë me vendim Nr. **627/2023; 626/2023 datë 14.07.2023**, ku i njëjti autoritet kontraktor në seancën dëgjimore të mbajtur pranë Ambienteve të Komisionit të Prokurimit Publik, për të njëjtin objekt-procedure ku janë ankimuar kriteret, ky i fundit është shprehur se: *“AK deklaroi që në Lejen mjedisore për AK nuk parashikohet si detyrim Matja e Radioaktivitetit”*

Pra në Ankesën e mëparshme për modifikimin e kriterit ku objekti i procedurës ishte i njëjtë me ankesën aktuale të berë nga operatori ekonomik ankimues AK ka cituar se *“Në seancë dëgjimore, përfaqësuesi i autoritetit kontraktor ndër të tjera deklaroi se: Leja mjedisore e ECO ELB është aplikuar dhe është marrë vetëm për depozitimin e mbetjeve dhe mqs operojmë vetëm për atë pjesë i gjithë projekti është në zhvillim për të shkuar më tej. Aktualisht Leja nuk e ka të përfshirë. Ndërkohë, autoriteti kontraktor pretendon, se kjo kërkesë është mbështetur në legjislacionin sektorial”*

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, lidhur me hartimin e kriterëve, në çdo rast duhet të ketë parasysh elemente të tilla si proporcionaliteti me objektin e kontratës, dobishmëria dhe nevoja që ndikon në vendosjen e kërkesës. Në rastin konkret KPP vëren kërkesat për *“një laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për matjen e parametrave të mikroklimës, zhurmës, cilësisë së ajrit në mjedis, cilësisë së ajrit në shkarkime stacionare, cilësisë së ujit dhe të radioaktivitetit” dhe 2.3.11 Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj”*, këto kërkesa mbi matjen e parametrave të radioaktivitetit dhe matjet e mbetjeve të letrave dhe kartonit lidhur me objektin e prokurimit, “Specifikimeve teknike” nuk janë proporcionale, nuk janë të pershtatshme për arritjen e synimit të kërkuar duke iu referuar objektit këto kërkesa shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar termave të shërbimit dhe specifikimeve teknike, në kërkesat e mësipërme nuk është kërkuar matja e parametrave për radioaktiviteti dhe mbetjeve urbane, specifikisht letra karton. Akoma me tej, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në hartimin e kriterit për matjen e parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbajtjeve si letra, karton, nuk ka specifikuar elementet për të cilat

do testohen në letër karton etj., gjë që krijon konfuzion për përmbushjen e këtij kriteri ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

KPP gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është kryerja e shërbimit të *Monitorimit të parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore*. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në vendosjen e këtyre kriteve ka kufizuar numrin e pjesëmarrësve, duke ulur konkurrencën dhe duke sjellë pabarazi në rrethin e ofetuesve të interesuar për këtë procedurë prokurimi. Në rastin konkret, KPP vlerëson, se kriteret e mësipërme kanë shkelur një ndër parimet e mësipërme, atë të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, parim i cili është një parakusht *sine qua non* i realizimit të objektit dhe qëllimit të vetë ligjit për prokurimin publik, atë të trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor gjatë hartimit të kriteve të dokumenteve të prokurimit objekt-ankimi, duhet të kishte pasur parasysh parashikimet ligjore e konkretisht, nenin 2 dhe nenin 3 të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar. Në këto kushte, KPP gjykon, se kriteret sa më sipër të hartuara nga autoriteti kontraktor, duke e ekzagjeruar me kërkesat e tij lidhur me proporcionalitetin e objektit të prokurimit, ka shkaktuar pabarazi në vlerësimin e ofertuesve dhe njëherazi ka vështirësuar punën e KVO-së, duke qenë të kushtëzuar të bëjnë vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.2 Gjithashtu, lidhur me kërkesën e mësipërme, ku operatori ekonomik duhet të ketë “*një laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për matjen e parametrave të mikroklimës*” KPP vëren, se kriteri i vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor për matjen e parametrave të mikroklimës për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, krijon konfuzion dhe lë vend për interpretime të ndryshme në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në këtë procedurë prokuruese. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor me vendosjen e këtij kriteri, krijon paqartësi për operatorët ekonomikë në përmbushje të kriterit, ndaj AK duhet të kishte vendosur kriterin më të qartë, se kush janë elementet pjesë e matjes së parametrave të mikroklimës.

III.3 Akoma me tej KPP vëren, se kriteret e vendosura nga ana e autoritetit kontraktor, si për pikën 2.3.11 dhe për pikën 2.3.7 togfjalëshi “*etj.*”, vendosur në këto kriteret, krijon konfuzion për operatorët ekonomikë të interesuar pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Kriteret duhet të jenë të qarta dhe të sakta në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i kriterit, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

Sa me sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4 Komisioni Prokurimit Publik vëren, se referuar Sistemit të Prokurimit Elektronik, Autoriteti Kontraktor ka vijuar me hapat proceduralë, deri ne Konfirmimin e lidhjes së Kontratës, publikuar më datë 23.06.2023.

III.4.1 Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 3, gërma “c” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
- b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;
- c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji.

III. 4.2 Neni 96, pika 2 a, e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

Neni 96 Periudha e pritjes

1. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mund të nënshkruajë kontratën me fituesin e procedurës së prokurimit pa kaluar një periudhë e caktuar nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit, si më poshtë:

- a) të paktën 10 ditë kalendarike, në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) të paktën 7 ditë kalendarike, në rastin e procedurave të prokurimit nën kufirin e lartë monetar;
- c) të paktën 2 ditë kalendarike në rastin e prokurimeve me vlerë të vogël.

2. Periudha e pritjes, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet:

- a) në rastin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
- b) në rastin e procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues;
- c) në rastin e kontratave të lidhura në bazë të një marrëveshje kuadër apo të një blerjeje në sistemin dinamik.

III.4.3 Neni 119, Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

Neni 119 Pavlefshmëria e kontratave

1. Një kontratë do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme në rastet e mëposhtme:

- a) nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë pa publikuar paraprakisht shpalljen e njoftimit të kontratës, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji;
- b) kur nuk janë zbatuar parashikimet e këtij ligji në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim;
- c) kur nuk janë zbatuar rregullat për rihapjen e garës për kontratat e lidhura në bazë të një marrëveshjeje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara dhe në sistemin dinamik të blerjeve të ndarë në kategori;
- ç) kur kontrata është nënshkruar në kushtet e konfliktit të interesit;
- d) Nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë duke mos respektuar vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

2. Kontrata mund të mos shpallet absolutisht e pavlefshme edhe nëse ajo është lidhur jo sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të të gjitha aspekteve përkatëse, çmon se shpallja e pavlefshme e kësaj kontrate mund të cenojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm.

Interesat ekonomike të lidhura drejtpërdrejt me kontratën në fjalë, si kostot për shkak të vonesave në zbatimin e kontratës, kostot për shkak të shpalljes së një procedure të re

prokurimi, kostot për shkak të ndryshimit të operatorit ekonomik që do të zbatojë kontratën, si edhe kostot për shkak të detyrimeve ligjore si pasojë e pavlefshmërisë nuk konsiderohen çështje thelbësore të interesit të përgjithshëm.

3. Në rastin e konstatimit të situatave sipas pikës 2 të këtij neni, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të aplikojë zbatimin e masave të tjera administrative, si:

a) dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktor për shkeljet e konstatuara;

b) urdhërimin e autoritetit kontraktor për shkurtimin e afatit të zbatimit të kontratës për të minimizuar dëmin e shkaktuar.

4. Gjoha duhet të vendoset në raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por, në çdo rast, jo më shumë se 10% e kësaj vlere.

Rregullat e posaçme për këtë proces përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

III.4.4 Neni 118, Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik

1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.

3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitatat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;

c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji.

III.4.5 Me ndryshimin e ligjit, ankimuesi legjitimohet për të kryer ankesë në KPP dhe për procedurat ”Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” .

Referuar sa me sipër procedurës objekt-ankimi, KPP vëren se Autoriteti Kontraktor ka zgjedhur procedurën “*Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*”.

Pas verifikimeve në SPE, KPP vëren, se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat proceduralë, deri në Konfirmimin e lidhjes së kontratës, ku bazuar në nenin 96 të Ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” parashikohet shprehimisht, se “*Periudha e pritjes, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet:*

a) *në rastin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*”.

Në ligjin për prokurimin Publik nr. 162/2020, në nenin 119, parashikohen rastet kur jemi në kushtet e pavlefshmërisë së Kontratës.

Në rastin konkret, nuk ndodhemi para një parashikimi të tillë, pra që të ndodhemi në kushtet e pavlefshmërisë së kontratës sipas parashikimeve të nenit të sipërcituar, dhe në këtë kuadër KPP i sjell në vëmendje operatorit ekonomik, se bazuar në arsyetimin e pikës III.1.10; III.2; III.3, të këtij vendimi, jemi para një veprimi të autoritetit ose entit kontraktor në kundërshtim me dispozitat e ligjit, ndaj neni 118 pika C, i ligjit 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ka parashikuar të drejtën e operatorit ekonomik që t’i drejtohet organit të pushtetit gjyqësor dhe të kërkojë dëmshpërblimin në lidhje me humbjet ose demet që ka pësuar si rezultat i shkeljes së këtij ligji. Siç parashikohet shprehimisht në nenin 118 të LPP, Komisioni i Prokurimit Publik c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së këtij ligji.

III.4.6 Sa me sipër, lidhur me shkeljet e evidentuara nga Autoriteti Kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, del me vendimin deklarativ, në bazë të të cilit operatori ekonomik ankimues mund t’i drejtohet pushtetit gjyqësor, i cili mund të shpërblejë ankuesin që ka pësuar humbje apo dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji.

III.5 Lidhur me evidentimin e kryer nga autoriteti kontraktor në procedurën e rivlerësimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, ku autoriteti kontraktor ka kryer shkelje të ligjit dhe rregullave të prokurimit, si dhe parimeve kryesore mbi bazën e të cilave është hartuar ligji për prokurimin publik, referuar çështjes së mësipërme, KPP gjykon, se ky rast duhet t’i referohet Agjencisë së Prokurimit Publik, për nisjen e hetimit administrativ kundrejt Autoritetit Kontraktor, bazuar në nenin 23, të Ligjit nr. 162/2020, “*Për Prokurimin Publik*”.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*”, me Nr. REF-72711-06-15-2023, me objekt: “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore”, me fond limit 750.000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, “ECO – ELB” SHA.
 2. Të marrë vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji.
 3. Autoriteti kontraktor të këtë në vëmendje këto konstatime në lidhje me procedurat e tjera që do të zhvillojë.
 4. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimeve në bazë të konstatimeve të bëra në këtë vendim.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK .
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri